



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 07/2011
Prishtinë, më 26.04.2011, ora 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-202

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Berta Buzhala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostić.

Mungoi: Teuta Sahatqija.

Të ftuarit për raportim: Mimoza Kosari – Lila, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, Bernard Nikaj Këshilltar Politik- MTI dhe Gani Berisha- MTI.

Pjesëmarrës të tjerë: Haxhi Gashi- USAID, Natyra Kasumaj – KDI, dhe Ukë Gashi - ZPRK.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 15 dhe 19.04.2011;
3. Shqyrtimi ne parim i Projektligjit nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditim;
4. Shqyrtimi ne parim i Projektligjit nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare;
5. Shqyrtimi ne parim i Projektligjit nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e brendshme;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – kërkoj nga anëtarët e Komisionit që pikat e propozuara për rend dite tre (3), katër (4) dhe pesë (5), të shqyrtohen si një pikë e rendit të ditës, si pika e tretë (3) për shkak të natyrës së lëndës dhe prezencës së ministres.

Propozimi u përkrah nga Komisioni dhe rendi i ditës u miratua si në vijim:

1. *Miratimi i rendit të ditës;*
2. *Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 15 dhe 19.04.2011;*
3. *Shqyrtimi në parim i Projektligjeve: nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditim; nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare; nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e brendshme;*
4. *Të ndryshme.*

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 15 dhe 19.04.2011

Myzejene Selmani - kërkoj nga stafi mbështetës i Komisionit që tani e tutje në procesverbal fjalimi i saj të transkriptohet fjalë për fjalë. Për shkak se nuk po përfshihen fare në procesverbal as ato çka janë esenciale në diskutim.

Berat Buzhala - pyeti se si stafi mund ta dijë se cila është vetëm çështje esenciale e cila jo, që do të përfshiheshin në procesverbal?

Kryetari – autorizoj stafin mbështetës të Komisionit që diskutimi i deputetes Selmani të transkriptohet në procesverbal.

Lutfi Zharku - kërkoj që shtohet edhe ky tekst në pikën e katërt të rendit të ditës së Procesverbalit të datës 19.04.2011, si në vijim: “Sa i përket ligjit për akreditim, aty është vetëm një dispozitë e cila është e paqartë, së thuhet që drejtorja e akreditimit e bënë vlerësimin e gjitha organeve të autorizuar edhe nga ministrit tjera. Por nuk sqarohet asgjë më tutje, së çka nëse drejtorja e akreditimit jep një vlerësim pozitiv apo negativ që rregullon vetëm vlerësimin në parim, ishte dashur të jetë diçka më në detale. Çështja e ligjit për Tregtinë e brendshme është një nderë fushat ku kemi probleme më të mëdha në raport me Bankën Botërore për të bërë biznes. Ajo është një fushë në të cilën fillimi e biznesit është klasifikuar si një ndër fushat ma problematike në zhvillimin e biznesit dhe regjistrimin e biznesit. Ligji për tregtinë e brendshme në mënyrë sipërfaqësore i cek disa çështje, nuk thellohet në brendësin e ligjit. Ku po e ceku rastin hiqen lejet e Kuvendeve komunale më një nen, ku neni tjetër thotë prapë të ju mbetët leja për punë nga Kuvendët komunale. Në përkufizim kemi konsumator mesatar, ku teknikisht mbi ndesh më ligjet tjera, ku thuhet që ministria lëshon udhëzime administrative dhe rregullore etj. Kështu që në parim përkundër asaj që mundet më u keqinterpretuar në rastin tim, duhet që ministrisë t’i jepet edhe një raste që deri ka qershori të punojë këto projektligje në mënyrë shumë më të detajuar.”

Procesverbalet nga mbledhjet e datës 15 dhe 19.04.2011, u miratuan më vërejtjet e cekura më lartë.

3. Shqyrtimi ne parim i Projektligjeve: nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditim; nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare; nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e brendshme;

Kryetari – theksoj se siç jemi pajtuar në mbledhjen e kaluar, për sqarimin më të detajuar të këtyre projektligjeve ta ftojme Mimoza Kusari – Lila, ministre në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Dhe e ftoi që t'i praqes sqarimet e nevojshme për këto tri (3) projektligje që janë në rend dite.

Mimoza Kusari – Lila (ministre në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë) – paraqiti një ekspozë për të tria projektligjet më radhë, si në vijim: *Projektligji nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare*, ARBK me qëllim të përmbushjes së objektivave të Qeverisë së Kosovës në fushën e regjistrimit të bizneseve dhe tejkalimin e situatës së krijuar në lidhje me shfuqizimin, sipas nenit 236.2 Ligji Nr.02/L-123 Për Shoqëritë Tregtare thuhet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2001/6 dhe urdhëresa Administrative Nr.2002/22 shfuqizohen. Ndërsa sipas Rregullorës së UNMIK-ut nr.2008/26 shtohet fjala me këtë formulim: Çdo dispozitë në rregulloren 2001/6 dhe në Urdhëresën Administrative Nr.2002/22 të cilës i referohen mbetet në fuqi dhe shfuqizon çdo dispozitë të këtij Ligji që nuk është në pajtim me Rregullorën Nr.2001/6 dhe me Urdhëresën Administrative Nr.2002/22. Qëllimi i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit Nr.02/L-123 “Për Shoqëritë tregtare” është krijimi i kushteve që ky Ligj të gjej zbatueshmëri të plotë. Ky projektligj përmban 21 nene dhe është i harmonizuar me ligjet tjera në fuqi po ashtu është i harmonizuar me direktivat dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian. Formatizimi dhe standardizimi është bërë në Departamentin ligjor të MTI-së ku janë përfshirë institutet përkatëse juridike, duke iu përshtatur kushteve dhe rrethanave ekzistues në Kosovë dhe duke përfshirë edhe instrumente përkatëse ndërkombëtare të parapara me Kushtetutë. *Projektligji nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditim*, aktualisht ekziston Ligji Nr. 03/L-069 “Për Akreditimin” mirëpo gjatë raportimit të Drejtorisë së Akreditimit në Komisionin Evropian në Qershor të vitit 2010 anëtarja e KE ka sugjeruar që Ligjin për Akreditim ta harmonizojmë me Rregulloren 765/2008 e cila ka hyrë në fuqi me 1 Janar të vitit 2010. Kjo situatë ka kërkuar dhe sjellë nevojën e ndryshimit të ligjit në fuqi. Poashtu nëse Drejtoria e Akreditimit nuk e harmonizon Ligjin me këtë Rregullore do të ketë vështirësi në plotësimin e kërkesave të EA-se European Corporation for Accreditation, e që rrjedhin nga kjo Rregullore. Prandaj përmes hartimit të Ligjit në fjalë do të bëhet eliminimi i mangësive ekzistuese që e mbulon këtë fushë. Projektligji përmban gjashtë (6) nene, është harmonizuar me Rregulloren e Bashkimit Evropian dhe ligjet tjera në fuqi. Arsyeshmëria për propozimin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit Nr.2004/18 për tregtinë e brendshme, është krijimi i kushteve që ligji të gjejë zbatueshmëri të plotë. Poashtu disa nene të këtij ligji janë në kolizion me ligje tjera dhe në raste të caktuara vështirësojnë zbatimin e tij dhe ligjeve tjera si: Ligji për shoqëritë tregtare dhe Ligji për inspektoratin e tregut. *Projektligji nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e brendshme*, drafti i parë i projektligjit është hartuar nga Departamenti i Tregtisë në bashkëpunim me Departamentin Ligjor përmban 14 nene. Ky projektligj është harmonizuar me Ligjet tjera në fuqi andaj edhe ndryshimet në këtë ligj i janë përshtatur rrethanave në Kosovë. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/18 Për tregtinë e brendshme është i harmonizuar me direktivat dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe është në përputhje të plotë me praktikën e hartimit të legjislacionin sa i përket harmonizimit dhe standardizimit.

Myzejene Selmani - Edhe ne mbledhjen e kaluar ne biseduam lidhur me çështjen e këtyre ligjeve. Unë kisha me startua me projektligjin e parë për ndryshim dhe plotësim për shoqëritë tregtare, me qenë se ministresha i ka dorëzua ndryshimet edhe intervenimet në këtë projektligj. Por unë mendoj se këto dorëzohen mbas leximit të parë edhe në tërësi në rast se ne e kemi bërë

një ndryshim për strategjinë e zhvillimit ekonomik dhe dëshirojmë që Kosova të hiqet nga ranglista e bankës botërore nga vendi 119 të vijmë në vendin e 40-të për të bërë biznes. Atëherë ky Ligj aspak nuk i plotëson konditat për biznes ashtu si po paramendoj unë për zhvillim ekonomik. Ligji për shoqëritë tregtare ka ngel në Komisionin e kaluar për arsye të shpërndarjes së Kuvendit ku është shumë e vërtet se ai Ligj ka qenë i përfundum nga përfaqësuesit e USAID-it amerikan të cilët na kanë mbështetur mjaft mirë që ky Ligj të implementohet me rekomandime të bankës Botërore që të bëjmë biznes më lehtë në Kosovë. Edhe njëherit kisha kërkuar në mënyrën më të sigurtë të mundur sepse ministresha në këtë aspekt nuk mundet me u marrë me të gjitha vërejtjet edhe të gjitha amendamentimet e Ligjeve, mirëpo duke pasur parasysh se stafi mbështetës dhe stafi i drejtorisë përkatëse mbrenda ministrisë ta marrin këtë Ligj dhe ti vendosin të gjitha rekomandimet e Bankës Botërore edhe e keni Ligjin e përfundum mbrenda këtij Kuvendit dhe të shihni se çka ka parapa USAID-i amerikan që ky ligj të jetë ai ligj më të cilin Kosova të renditet në vendin e 40-të për biznes dhe ti thoni ministreshës se ky Ligj është në rregull. Dhe atëherë nëse amendamentohet mbi 40% të Ligjit në leximin e parë atëherë në bazë të Rregullorës së punës së Kuvendit, qysh ka funksionua në vitin e kaluar i kthehet Qeverisë. Dhe mos me u kthi ky ligj është mirë që të mirret dhe të plotësohet ndryshohet një ditë tjetër ose në muajin tjetër dhe ju departamentet mbrenda ministrisë ti merrni rekomandimet e Bankës Botërore dhe ti përmirësoni. Në rast se kalojmë te ligji për tregti të brendëshme ju them shumë sinqerisht se i keni përzi kompetencat edhe me Ministrinë e ekonomisë dhe financave nuk e di a keni ju aty mbrenda jurista se me pa se cilat kompetenca i takon Ministrisë të financave e cila i takon Ministrisë së tregtisë dhe industrisë. Ndërsa Ligji për akreditim veq është miratua, drejtori është veq ketu prezent dhe e din se është miratua në vitin 2009-të ligji i parë dhe ato rekomandime ku shumë kuarti i prezentoj ministresha që duhet të hyjnë në ligj, po ato kishin mundur fundi fundit edhe me një udhëzim administrativ. Ndërsa i gjithë diskutimi të jetë për udhëzime administrative, në ligj nuk përfshihen ato. Janë në material shtesë, në material sekondar dhe në rast se doni që Kosova të renditet në vendin e 40-të të Bankës Botërore për biznese ju kisha lutur në mënyrë më të sigurtë si deputet i këtij Kuvendi, që ta merrni këtë ligj ta përmirësoni dhe ti thoni ministreshës se e kemi vendosur ashtu si duhet dhe jo të i'a bini një ligj të tillë dhe të ballafaqohet në Kuvend të Kosovës, me pro dhe kontra ligjit, se përmes Ligjit mund ta ndryshojmë ambientin biznesor e jo vetëm të thuhet se po dëshirojmë ta ndryshojmë ambientin biznesor.

Visar Ymeri – theksoj se këtu te ndryshimet veçanërisht te ligji për tregtinë e brendshme ka deri në një masë shumë shkurtime të afatesh sikurse në aspektin e ankesave ashtu edhe në aspektin e regjistrimit të bizneseve. Edhe natyrisht ky shkurtime i afateve nuk është që nuk e bartë një rrezik në vete. Tha se është shumë i dëmshëm shkurtime i afateve në qoftë se ministria nuk i ka kapacitetet e mjaftueshme, qoftë në ndërtim e sipër qoftë tashmë të ndërtuara në mënyrë që ti trajtojnë këto ankesa në mënyrën e duhur përbrenda afatit të shkurtuar. Pyeti se a ka ministria kapacitete me i përmbush këto afate siç parashihet në projektligj?

Ramiz Kelmendi – paraqiti shqetësim në lidhje me biznesin individual agrar me qenë se kemi shumë biznese individuale agrare të cilat nuk kanë fuqi të bizneseve të ndryshme të jetë një kategori. Nën dy, dënimet e mëdha paraqesin shqetësim në veti duke e ditur të ardhurat personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe shtoj se dënimet e mëdha nuk janë mjet e edukimit të qytetarëve por munden me qenë mjet i korrupsionit në mes të dënuesit dhe përfituesit. Përgjegjësi juridik duhet të kuptohet përgjegjësi i objektit që ekziston i cili e ka kryer veprimin e caktuar e jo kompania si përgjegjës juridik nëse një pikë shitëse në një dyqan diku në tërë Kosovën nuk i respekton rregullat gjoba duhet ti takoj personit fizik që e menaxhon atë objekt e jo kurrësi kompanisë e cila mund të ndodhet me seli në shtetin tjetër. Propozoj që dënimet duhet së pari fillestare më të vogla e pastaj të kthehen edhe pak më të larta e jo kurrësi në këtë vlerë se është e pamundur një dënim prej 15 mijë eurove nëse kthehet ai në burg del se duhet të shkojë tri vjet në burg për ta paguar këtë dënim.

Lutfi Zharku – theksoj se së pari duhet ti bëjmë disa sqarime për anëtarët e Komisionit. Projektligji për shoqëritë tregtare është e vërtet se është aprovuar prej Kuvendit në mars të vitit të kaluar dhe atë që e kemi thënë edhe më herët se gjatë kësaj kohe nuk janë përfshirë ndryshimet nga Komisionin i kaluar por edhe nga ministritë që kemi biseduar për ndryshimet plotësuese për ndryshimet në ligj me përputhje të rekomandimeve të USAID-it dhe Bankës Botërore. Kurse dy ligjet e reja, Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin mbi Akreditimin dhe Plotësimin dhe Ndryshimi i Ligjit për tregtinë e brendshme janë Projektligje të cilat janë plotësuar strategjisë legjislative në shtator të vitit të kaluar të cilat janë të rregulluara rishtas nga ministria. Kështu qëndron puna, e jo ajo që po thuhet se ligjet nuk janë aprovuar për shkak të shpërndarjes së Parlamentit. Projektligjet kanë shumë paqartësi se nuk janë punuar në masën e cila duhet i nevojiten ekonomisë së Kosovës për reformat e proklamuar nga ana e Qeverisë. Te projektligji për tregtinë e brendshme kemi shumë çështje të cilat kanë mbet pezull dhe nuk e shohim konceptin e organizimit të tregtisë së brendshmen në Kosovë. Kurse të projektligji për akreditimin sikurse edhe herën e kaluar kemi vlerësimin nëse drejtoria e akreditimit duhet të bëjë vlerësimin e grupeve të autorizuar dhe nuk e dimë se ai vlerësim është obligativ apo vetëm rekomandues. Ne fund tha duhet të jemi të kujdesshëm sepse ne kemi raste po them edhe nga përvoja ku kemi pasur raste që nganjëherë ku Parlamenti aprovon një ligj i cili është në kundërshtim me një ligj tjetër.

Hashim Deshishku – theksoj se e kemi këtë material të sjellë nga ministria vetëm para dy minutash para mbledhjes dhe për këtë arsye nuk mund me dhënë ndonjë sqarim.

Kryetari – tha se vetë prezenca e ministres dhe materialet shitesë të cilat i ka sjellë janë çështje për të cilat u morëm vesh për ti aprovuar këto projektligje ne parim. Të gjitha kushtet janë për një procedim në parim dhe dërgim të mëtutjeshëm të këtyre projektligjeve, dhe janë të sqaruara edhe Raportin i cili vjen nga Divizioni për standardizim dhe harmonizim ligjor në Kuvend.

Mimoza Kusari – Lila (ministre në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë) – u përgjigj në pyetjet e deputetëve: sa i përket znj.Selmani dhe faktit lidhur me Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin për shoqëritë tregtare u përmenden edhe rekomandimet edhe tek ishministri Zharku, edhe të Bankës Botërore dhe të USAID-it. Duhet të ju rikujtoj të dy deputetëve se Banka Botërore dhe USAID-i ka pasur përfaqësuesit e tyre në grupet punuese në këto Projektligje pra në plotësimin dhe amendamentimin e tyre në shkurt të vitit 2011-të. Është krijuar një komision në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili ka marrë për bazë të gjitha problemet që të ngritën në kuadër të ambientit të biznesit dhe vendimin të cilin në fakt e kam dhe të përfshirë në të janë edhe përfaqësuesit e USAID-it dhe në qoftë se ka komente të cilat mund të mi specifikoni të cilat nuk janë përfshirë ne me shumë kënaqësi i marrim mbrapa dhe i diskutojmë edhe një herë. Znj Selmani e përmendi se ndryshimet dhe plotësimet në ligjin për tregtinë e brendshme ka përzierje të kompetencave me Ministrinë e ekonomisë dhe të financave. Një ministri e tillë më nuk ekziston është Ministria e financave ose Ministria për ekonomi dhe Zhvillim nuk e di për cilën ministri keni menduar në veçanti. Për Ministrinë e financave nëse mendohet lidhur me pjesën e gjobave ose mundem të them vetëm hipotetikisht se për cilën pjesë keni aluduar por ka të bëjë tërësisht me kompetencat që edhe më herët të inspektorati në kuadër të veprimtarisë së inspektorëve nuk e di se ku janë sepse sa duket nuk janë në pjesën ku janë bërë ndryshimet e parapara në këtë ligj. Ndërsa sa i përket ligjit për akreditimin, ato komente të cilat i përmendet ju znj.Selmani lidhur me 2009-ën është e vërtet se në raportimin në qershor të vitit 2010-të janë marrë brengat d.m.th jemi duke folur për një projektligj që pas raportimit që është bërë nga Ministria e tregtisë dhe industrisë, ku ish Ministri e din më mirë në Komisionin Evropian janë marr këto komente dhe na është prezantuar ky projektligj me ndryshime të cilat kanë reflektua para jush. Z.Ymeri e pati brengën e kapaciteteve në përgjithësi e ftojë të gjithë Komisionin që të vini në kuadër të Ministrisë së tregtisë dhe industrisë, që të vini dhe mund të them me keqardhje se në përgjithësi kapacitetet e shërbyesve civil në nivel të ministrisë, nuk janë ato të cilat i

nevojiten një ekonomië të hapur që shkon drejt. Për arsye ajo çka ka rezultuar ka një mbingarkesë të shërbyesit civil dhe mungesë efikasiteti. Çka ajo që ne synojmë me shkurtim afatesh është një ngritje e performancës, një monitorim më i afërt i procesit ankimor d.m.th që nga procesi i infrastrukturës fizike. Është një proces që do të mbahet me një monitorim shumë të ngushtë dhe të afërt dhe do të jetë i hapur për të gjithë pra edhe ato kompanitë të cilat marrin përgjegjësi ose të cilat nuk mundën me qenë të kënaqura me përgjigjen që e kanë marrë nga departamentet ose agjencitë e caktuara të ministrive përkatëse Ministrisë së tregtisë dhe industrisë do ta kenë mundësinë e kthimit mbrapa të atij procesi dhe rishqyrtimit por ne besojmë që të mos vije deri aty sepse ideja nuk është që ta prolongojmë procesin por ta shkurtojmë duke marrur përgjigje efektive. Sepse shpesh herë afati kohor i zgjatur ka ofruar mundësinë e mos kthimit të përgjigjes. Edhe e dyta ajo që është përmend këtu më herët nga z.Kelmendi të korrupsionit për të kthyer përgjigje më shpejtë, kur kompanitë janë të obliguara me ligj që ta kenë një afat më të shkurt të njëjtën shqyrtim të ankesave do ta bëjnë për 10-të ditë sikurse këta për 60-të ditë por do të ndijnë një obligim për përmbushje të kësaj. Pra është në kuadër të shkurtimit të afateve të përgjithshme dhe shpresojmë që lidhur me shkurtimin e lejeve, licencave që institucionet e Kosovës si në nivelin lokal apo si në nivelin qendror i japin për biznese. Z.Kelmendi i përmendi disa çështje kategorinë e biznesit agrar, ju e dini se kur regjistrohen bizneset regjistrohen në bazë të madhësisë dhe kapitalit d.m.th nuk ka ndonjë kufizim për biznese si kategori ne mund ta diskutojmë ta fusim në raport mbasi që është në kuadër të prioritetëve zhvillimore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është bujqësia. Sa i përket dënimeve ka zvogëlim të dënimeve por pajtohem me ju se sa të ketë dënime më të mëdha ekziston edhe mundësia jashtë sistemit të aspektit të realizimit të përmbushjes por ajo ndodh në secilin instancë tatimore mund të ndodh në inspektorat. Z.Zharku i pati komentet e përafërta me znj.Selmani në raport me përfshirjen e komenteve.

Ramiz Kelmendi – kërkoj ti qartësoj gjërat lidhur me çështjen regjistrimin të biznesit agrar, për shkak se procedura e mëtutjeshme e fiskalizimit të mëtutjeshëm të arkave e nxjerr një biznes individual agrar të ketë një numër me të cilin do të ketë lirime tatimore për punën e vetë që e bënë, dhe të regjistrohen të hyrat në mënyrë që të vërehet ngritja e të hyrave për qytetarët e Kosovës.

Berat Buzhala - theksoj se secili nga ne pajtohet me amendamentimin dhe ndryshimin e këtyre projektligjeve, dhe këto të gjitha kanë me kaluar edhe në Kuvendin e Kosovës dhe të gjitha ndryshimet të cilat mund të bëhen pastaj në shqyrtimin e dytë. U pajtua me z.Ymeri, që këto ndryshime nuk duhet me u bërë vetëm sa për me u bërë, por mbetet tek Ministria që ti shtrëngoje rripat e vet edhe të jetë më efikas e jo vetëm të ndryshohet ligji por këto ndryshime ti hasim në praktik në punën e ministrisë. Në fund kërkoj që të miratohen në parim nga Komisioni këto projektligje.

Visar Ymeri - theksoj se përveç kësaj që u përmend që nëse është ligji me përputhje me gjobat e legjislacionin tjetër, më e rëndësishme është zbatueshmëria e ligjit. Në njërin anë problemet praktike që i përmendi z.Kelmendi që mund të ndodhin, në anën tjetër përgatitjet e ministrive që është e gatshëm për ta zbatua ligjin, e në këto pika ku këta shofin shkurtim afatesh. Nuk është pjesa kryesore e ligjit, por është një çështje shumë e rëndësishme se ky shkurtim i afatesh mund të jetë i mirë por mund të jetë edhe shumë i keq, nëse nuk zbatohet si duhet. Sepse nuk ka nevojë Kosova që të miratojë ligje vetëm sa për sy e faqe të cilat e dimë paraprakisht se nuk do të zbatohen. Në fund tha se, Kosova nuk duhet të funksionoj nga raportet që shkruhen nga jashtë por duhet të udhëhiqet nga rrethanat e brendshme edhe nga nevojat e brendshme.

Berat Buzhala – theksoj se të gjitha këto ndryshime të cilat mund të bëhen nuk do jenë vetëm ndryshime sa për sy e faqe. Sepse kjo nuk është mbledhja e fundit që po e mbahet por duhet me kërkuar përgjegjësi nga ministria se pse nuk po respektohen këto ligje dhe pse nuk po respektohen

edhe ndryshimet të cilat po bëhen edhe lidhur me afatet edhe me procedurat edhe me gjithçka tjetër. Prandaj, duhet me ju hap rruga aprovimit të ligjit me vërejtjet dhe sugjerimet tona, e mandej të kërkojmë llogaridhënie edhe nga ministrja edhe nga ministrinë tjera se në çfarë rruge është duke shkuar zbatimi i këtyre ligjeve.

Mimoza Kusari – Lila (ministre në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë) – i falënderoj të gjithë deputetet dhe natyrisht i mirëpriti komentet dhe theksoj se nuk aludojmë se do të krijohet diçka përfikthe, dhe besimin se me miratimin e një ligji menjëherë çdo gjë do të rregullohet. Në teren më gjithë atë një gjë e cila nuk mund të tolerohet është situata aktuale që ekziston edhe format e interaksionit në mes të nivelit qoftë lokal qoftë qendror me bizneset. Te tri Projektligjet e prezantuara këtu e kanë synim përmirësimin e bashkëpunimit në mes të komunitetit të biznesit të atyre institucioneve lokale apo qendrore, por edhe përmirësimin e kushteve për afarizëm të biznesit. Pa e ndryshuar situatën aktuale ne nuk kemi mundësi që ta ndryshojmë sjelljen qoftë si institucion shtetëror apo si institucion lokal dhe pa hy në fuqi ligji i cili e heq lejen e punës për nivelin lokal, tha z.Kusari-Lila. Dhe pozicioni e Kosovës në indikatorët e Bankës Botërore duhet ti vendosim vetit kritere më të ashpra si institucione në performancën tonë, nuk mund ti arrijmë ato synime për arsye se del vetëm si një rrugë kot mas koti. Prandaj për ne është e rëndësishme miratimi i Projektligjeve në parim, në mënyrë që së bashku me ju se sa herë që të ftohemi në këtë Komision, do jemi këtu ti bëjmë plotësimet e nevojshme ti marrim rekomandimet e juaja në mënyrë që të dalim prej kësaj gjendje. Sepse, besoj se si pozita, po ashtu edhe opozita e kanë të gjitha mandatin që ta shikojnë Kosovën në një pozicion më të mirë se siç është sot, e pozicioni më i mirë është kur Kosova e ka një ambient më të mirë dhe më të sigurt të biznesit.

Visar Ymeri – sqaroj se nuk është pro asaj se duhet të bllokojmë këto projektligje sepse dhe natyrisht është në interes të të gjithëve me i zhbllokuar. Por, duhet që të kemi pak më shumë kujdes me reflektuar pak më shumë siguri se ka me u zbatua ky ligj. Në përgjigjen e juaj ju nuk rezultat siguri dhe kjo është brengosëse d.m.th në vend se të thoni se i keni marr këto masa, apo ato masa, ju po thoni se shpresoj se do ti zbatojmë sepse Kosova nuk i ka punët keq me ligje. Kosova i ka punët keq për mos zbatueshmërinë e ligjeve. Sepse kjo shpejtësia ku regjistrohet biznesi dhe ku çregjistrohet biznesi, është e mirë në njëfarë mënyre se e lehtëson zhvillimin e biznesit, ndërsa në njërën formë nuk ka kapacitet apo mekanizëm për mbikëqyrjen se si po regjistrohet, dhe mund ta shkaktoj njëfarë mjedisi shumë të rrezikshëm të asaj që quhet kapital i nxehtë të hyrjes dhe daljes dhe ta degradon në njëfarë mënyre mjedisin ekonomik. Kërkoj që të paktën duhet të trego ministria dhe ta dëshmoj se i keni ato mekanizma që në rast se ndodh skenari A, e keni B, ne rast se ndodh C e keni D-në, gjë që deri tani nuk është dëgjuar, prandaj u ngritën këtë çështje, tha në fund z.Ymeri.

Kryetari – theksoj se sot nuk duhet që ti shterim të gjitha pyetjet, dhe kërkoj që të kufizohen vetëm në temën që është ne rend dite dhe kjo temë është aprovimi i mundshëm në parim i këtyre Projektligjeve. U'a përkujtoj edhe një herë deputetëve që formalisht që me Rregulloren e Kuvendit, këto Projektligje i plotësojnë kushtet për me i miratua në parim. Pra në përputhje me nenin 54, se projektligjet kanë shkresën shpjeguese, deklaratën për ndikim buxhetor, deklaratën për afim dhe harmonizim me legjislacionin e BE-së dhe është i harmonizua, asketi profesional juridik, dhe i kemi rekomandimet përkatëse nga Divizioni për harmonizim dhe standardizim ligjor i Kuvendit që mund të procedohen tutje. Shtoj se në asnjë pikë të veçantë në Rregullore të Kuvendit, nuk thotë se ndryshmi i më shumë se 40% i projektligjit i kthehet Qeverisë.

Ramiz Kelmendi – theksoj se ne kemi obligim për bizneset agrare individuale sepse ne asnjëri nuk jemi agrar këtu dhe nuk e dimë se çka është ajo. Kur dikush të dënohet më gjohë me shumë prej 15 mijë eurove, dhe zakonisht dënohen ata që nuk kanë fuqi politike çka do të bëjë ai në familjen e vet. Kosova nuk ka vende të punës të mjaftueshme që njerëzit të mos bien ndesh me ligjin. Prandaj të gjobiten njerëzit të cilët nuk janë aty gjate inspektimit të mallit të tyre se vetëm

pse po thotë ligji, është dashur shumë qartë këtu me u amendamentuar, për shkak së u kemi premtuar në fushatë që do ti mbrojmë të tjerët të cilët nuk janë këtu me ne, tha z.Kelmendi.

Sala Berisha Shala – theksoj se për ato të cilat po i thotë z.Kelmendi, dhe ne nëse dëshirojmë me e rregulluar diçka të tillë, duhet ti japim shanse këtyre projektligjeve dhe ti miratojmë në parim. Sepse siç po vërehet, veç procedura si duket nuk është shumë e çartë për deputetët. Përndryshe nëse ne i kthejmë kështu në pafundësi ne kthehemi mbrapa. Bëri thirrje në fund që ti ipet shans, të votohen në parim sepse procedura është e tillë pastaj të ulemi si Komision një muaj, dy muaj apo edhe një vit dhe të bëjmë më të mirën e mundshme.

Kryetari – sqaroj për deputetët se kjo është procedurë e Kuvendit d.m.th njëherë miratohen në parim dhe pastaj kthehen projektligjet përsëri në Komision dhe në bëjmë grupin punues dhe amendamentojmë projektligjet dhe në atë fazë pra kemi mundësinë më i fut propozimet tona në formë të amendamenteve dhe pastaj të shkon në lexim të dytë dhe miratohet.

Pas debatit Komisioni me pesë (5) vota Për dhe pesë (5) vota Kundër, asnjë abstenim, nxori këtë

Përfundim

Nuk miratohen në parim Projektligjet: nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditim; nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare; nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e brendshme.

Dhe Kuvendit i parashtrohet këtë

Rekomandim

1. Të mos miratohet në parim, Projektligjin nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditim; Projektligjin nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare; dhe Projektligjin nr.04/L-007 Projektligji nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e brendshme;

2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

4. Të ndryshme; Çështje vijuese

Kryetari – i njoftoi deputetët së mbledhja e radhës do të mbahet më datë 03.05.2011, ku do të shqyrtohet Raporti vjetor për vitin 2010 i Agjencisë Kosovare të Privatizimit – AKP-së.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit**